



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.41/2016

Prishtinë, më 26 tetor 2016

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Mytaher Haskuka dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Nenad Rashiq, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Agim Aliu- anëtarë të Komisionit për Legjislacion, Agron Gashi-ZL ZKM, Egzona Krasniqi-Kosova Press, Liridona Xhemajli-RTV-21, Visar Bivolaku-EUO/EUO, Flora Kryeziu-UNICEF, Teuta Prekazi-UN HUMAN RICHTS, Mirlinda Kolgeci, Komisioni për Legjislacion, Ukë Gashi-ZPRK, Agnesa Haxhiu-KOI, Salihe Salihu-DGBA Kuvendi i Kosovës dhe Nehat Dervishi- OSBE.

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, i hapi punimet e mbledhjes, ndërsa lidhur me pikat e propozuara ajo theksoi se:

Pika - Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Avokatit të Popullit për vazhdimin e mandatit trevjeçar për zëvendësitë e Avokatit të Popullit, të hiqet nga rendi i ditës, për shkak të pamundësisë së pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në këtë mbledhje.

Pika - Shqyrtimi i Raportit me rekomandime në lidhje me procedurën e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të radhitet pikë e rendit të ditës me nr. 2, për shkak të pranisë në këtë mbledhje të anëtarëve të Komisionit për Legjislacion.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetares.

Në vazhdim mbledhja e Komisionit i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime në lidhje me procedurën e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kryetarja konstatoi se procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 23 shtator 2016 dhe 30 shtator 2016, u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime në lidhje me procedurën e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lirije Kajtazi tha se këtë çështje e ka ngritur Avokati i Popullit dhe se kjo i është drejtuar edhe Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili e ka shqyrtuar edhe në prani të Avokatit të Popullit.

Në lidhje me këtë Propozim-raport të Avokatit të Popullit është ngarkuar për shqyrtim edhe Komisioni që ajo drejton, andaj për këtë arsye janë ftuar sot në mbledhje edhe anëtarët e Komisionit për Legjislacion, të cilët janë të pranishëm.

Më pas ajo hapi diskutimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Armend Zemaj tha se e kanë shqyrtuar këtë raport që ka të bëjë me dy çështje siç janë: një sqarim procedural dhe me një plotësim të rregullores së punës të Kuvendit që ka të bëjë me mandatin, raportimin e zyrës së Avokatit të Popullit.

Më tej, ai theksoi se si Komision, kanë kërkesë që të caktohen dy anëtarë nga Komisioni për Legjislacion dhe dy anëtarë nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, dhe të rishikohet ky material që e ka sjellë IAP, sepse kemi të bëjmë me çështjet kur tani rregullorja e Kuvendit të

Kosovës është në procedurë dhe mandati i juaj që ta rishikoni edhe ligjin për Avokatin e Popullit.

Albulena Haxhiu tha se si Komision e kanë debatuar me prioritet këtë raport dhe se ajo ka dilemë në kërkesat e IAP- së, sepse mund të përdoret si precedent për institucionet e tjera të pavarura të cilat me Kushtetutë e kanë për obligim që t'i raportojnë Kuvendit.

Ajo përkrahu idenë e formimit të një grupi punues të përbashkët lidhur me këtë çështje.

Salihe Mustafa tha se nuk mund të vendosim menjëherë lidhur me këtë raport, pajtohet që të formohet grupi punues i përbashkët i këtyre dy komisioneve dhe të shqyrtojmë edhe në prezencën e Avokatit të Popullit. Si komision në vazhdimësi e përcjellim punën e IAP- së, por kjo është një çështje pak më e komplikuar dhe së bashku do të vendosim për këtë.

Teuta Haxhiu tha se nga raportimi i institucioneve të themeluara nga Kuvendi dhe që raportojnë në Kuvend, e kemi parë një praktikë jo të mirë. Ne e kemi parë si emergjente që pikërisht të krijohet një komision për të parë çështjet e mos votimit të shumë raporteve dhe përgjegjësitë që askush nuk i ka marrë. Kuvendi ka ra në lajthitje pikërisht me institucionet të cilat i ka ngritur vetë, kemi pasur raste që sa herë Kuvendi nuk ka kaluar raportet e disa institucioneve dhe nga ana tjetër asnjë përgjegjësi nga askush. Ajo tha se e përkrah formimin e grupit punues të përbashkët të dy komisioneve dhe se IAP nuk është si të gjitha institucionet e tjera, raporti të vijë në Kuvend të diskutohet, por jo të vihet në votim.

Agim Aliu tha se si Komision janë dakorduar që të formohet një grup punues i përbashkët. Komisioni për legjislacion edhe më parë, ka diskutuar se si do të duhej trajtuar raportet që vinë nga agjencitë e ndryshme që raportojnë në komisione të ndryshme, si dhe në Kuvend. Çështja e raporteve në Kuvend është bërë tepër formale dhe një proces rutinor, ndërsa do të duhej që kjo çështje të shqyrtohet shumë seriozisht edhe për Avokatin e Popullit, por edhe për Institucionet e tjera.

Armend Zemaj tha se nëse kërkohen dy emra nga Komisioni për legjislacion do t'i keni dhe insistoi që kjo çështje të shqyrtohet në afatin sa më të shkurtër kohor, sepse do të procedohet edhe me ndryshimet në rregulloren e Kuvendit të Kosovës.

Albulena Haxhiu tha se kemi menduar se në qoftë se raportet nuk marrin përkrahjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, atëherë Komisioni FunkSIONAL të ketë të drejtën të rekomandojë shkarkimin e bordit, apo të drejtuesit të atij institucioni të pavarur.

Ajo tha se sa i përket emrave për grupin punues do t'i procedojmë me shkrim në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.

Lirije Kajtazi theksoi se pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, rezultoi që ta formojmë një grup punues të përbashkët, i cili do të përbëhet prej tre deputetëve, nga dy Komisionet FunkSIONALE. Ky grup punues do të përbëhet nga dy anëtarë të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë

Kundër Korrupsionit dhe një anëtar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Ajo propozoi deputeten Teuta Haxhiu, anëtare të grupit punues të përbashkët, nga Komisioni që ajo drejton.

Ajo po ashtu ngriti çështjen e Draft-udhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve, të hartuar nga Komisioni dhe kjo çështje do të duhet të kihet parasysh edhe gjatë punës në ndryshimet në rregulloren e Kuvendit të Kosovës.

Komisioni vendosi që Teuta Haxhiu, të jetë anëtare e grupit punues të përbashkët, nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

3. Shqyrtimi në parimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë

Lirije Kajtazi tha se lidhur me këtë projektligj, në mbledhje janë të pranishëm, përfaqësues të Qeverisë për të raportuar se çka është ndryshuar me këtë projektligj pasi që dihet se vitin e kaluar ky projektligj nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për miratim në parim në Kuvend.

Agron Gashi, përfaqësues i zyrës ligjore të kryeministrit, bëri një rezymë të punës në këtë projektligj.

Si zyrë ligjore kemi organizuar shumë takime, ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e bashkësive fetare, organizata që veprojnë në Kosovë, ambasada të ndryshme dhe aktorë të tjerë.

Më pas, ai tha se me këtë projektligj synohet të njihet edhe një bashkësi e re fetare, ajo e bashkësive të tarikateve të Kosovës, pastaj rregullohet edhe çështja e regjistrimit të bashkësive të reja fetare, zgjidhjes së çështjes së varrezave të disa bashkësive fetare, si të kishës protestante dhe çështja e financimit të bashkësive fetare.

Lirije Kajtazi tha se në parim ky projektligj i plotëson kushtet për miratim, ndërsa gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit, si Komision do të japim kontributin tonë që të kemi një projektligj sa më të kompletuar.

Teuta Haxhiu tha se është e interesuar të dijë për një bashkësi të re fetare, për komunitetin bektashian, dihet se qendrën e kanë në Tiranë dhe datojnë nga viti 1350, sipas informatave në Kosovë daton nga viti 1790, dhe propozoi që edhe ky komunitet që është mysliman të radhitet si bashkësi fetare në Kosovë.

Agron Gashi theksoi se është bërë një organizim i tarikateve të Kosovës që ka kërkuar evidentimin e tyre në projektligj, si bashkësi fetare dhe lidhur me këtë e kanë hartuar edhe statutin e tyre. Andaj ata janë të evidentuar në projektligj si bashkësia fetare e tarikateve të Kosovës.

Teuta Haxhiu kërkoi informacione se a është pjesë e tyre edhe komuniteti i bektashinjve të Kosovës.

Agron Gashi duke u ndërlidhur me këtë theksoi se përfaqësuesi i bektashinjve nuk ka marrë pjesë në takim me pretendimin se ata e kanë qendrën në Shqipëri dhe se nuk dëshirojnë të jenë pjesë e këtij Projektligji.

Teuta Haxhiu sërish kërkoi informacione se a kanë të dhëna me shkrim se ky komunitet ka bërë një kërkesë të tillë sipas të cilës nuk dëshirojnë të jenë pjesë e projektligjit.

Agron Gashi tha se nuk posedojnë ndonjë shkresë e cila e vërteton një deklaram të tillë, mirëpo vetëm deklarimet e përfaqësuesve të tarikateve të cilët kanë marrë pjesë në takim.

Mytaher Haskuka theksoi se nga takimet që kanë pasur me Bashkësinë Islame të Kosovës, kanë marrë informacione se projektligji i ri është krejt më ndryshe se projektligji i mëparshëm, ngjashëm kanë informuar edhe përfaqësuesit e Kishës Protestante të cilët kanë theksuar se nuk është diskutuar me përfaqësuesit e tyre çështja e projektligjit të ri për Lirinë Fetare në Kosovë. Lidhur me këtë çështje ai kërkoi informacione nga zyrtari që ishte prezent në mbledhje të Komisionit. Lidhur me numrin e personave të cilët kërkohen në bazë të projektligjit për të kërkuar krijimin e një bashkësie të re fetare, ai theksoi se kjo është shqetësuese, duke pasur parasysh se mundet që të vijë ndonjë fryme ekstremiste dhe të kërkojë krijimin e një bashkësie fetare dhe ai ishte i mendimit që duhet të rritet numri i personave që do të kenë të drejtë për regjistrimin e një bashkësie fetare. Ai përmendi edhe numrin e personave që kërkohet në vendet e tjera, p. sh. Austrinë, ku kërkohet që të jenë 16 000 persona.

Po ashtu ai paraqiti shqetësimet e tij lidhur me terminologjinë e bashkësisë ortodokse sipas të cilit nuk duhet që të identifikohet kjo me serbët sepse në praktikë një person për të kaluar në besimin ortodoks fillimisht do të duhet të bëhet serb, e pastaj ortodoks. Lidhur me këtë ai ishte i mendimit që përfaqësimi fetar nuk mund të identifikohet me përfaqësimin etnik, andaj kjo çështje duhet trajtuar me kujdes nga ana e Komisionit.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se ky projektligj duhet të rekomandohet për miratim në parim nga Kuvendi i Kosovës. Ajo, po ashtu, e përmendi se ky projektligj është mirë i formuluar gjuhësisht. Duke ju referuar përmbajtjes së projektligjit ajo përmendi nenin 4A, paragrafi 4.3 sipas të cilës bashkësitë fetare kanë të drejtë të regjistrohen dhe të kenë statusin e personit juridik. Ajo përmendi nenin 7B sipas të cilit bashkësitë fetare nuk janë të detyruara të regjistrohen dhe të pranojnë statusin e personit juridik kundër vullnetit të tyre. Lidhur me këtë ajo tha se pse duhet të ekzistojë një nen i tillë kur në nenin paraprak është saktësuar e drejta për t'u regjistruar dhe për të pasur statusin e personit juridik. Andaj ajo ishte e mendimit që kjo pikë të hiqet nga teksti i projektligjit.

Etem Arifi tha se ky projektligj duhet që të miratohet në parim nga Kuvendi i Kosovës. Sa i përket vërejtjeve apo sugjerimeve të anëtarëve të Komisionit ai theksoi se ata do t'i inkorporojnë amendamentet e tyre gjatë punës në vazhdim pas projektligji të jetë miratuar në parim nga Kuvendi. Në vazhdim, ai theksoi se pse duhet të jetë zyra për regjistrimin e bashkësive fetare pranë Zyrës së Kryeministrit.

Salihe Mustafa theksoi se pas miratimit në parim, Komisionin e pret punë e madhe në shqyrtimin dhe amendamentimin e tij në mënyrë që të eliminohen vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e tjerë të Komisionit. Ajo e theksoi se Komisioni do të organizojë edhe Dëgjim Publik lidhur me këtë projektligj dhe se aty do të paraqiten propozimet nga anëtarët e Komisionit, por edhe grupet e tjera të interesit.

Agron Gashi duke u ndërlidhur me pyetjet e parafolësve theksoi se në memorandum shpjegues të projektligjit janë precizuar të gjitha detajet që kanë rezultuar nga takimet e mëparshme edhe me bashkësitë fetare dhe në këtë mënyrë ata kanë vendosur për inkorporimin apo mos inkorporimin e çështjeve të caktuara. Sa i përket emërimit të komunitetit ortodoks, ai theksoi se kjo rrjedh edhe nga Plani i Ahtisarit dhe për këtë arsye është vendosur.

Mexhide Mjaku-Topalli e përsëriti mendimin e saj, sipas të cilës nuk është e nevojshme që të ekzistojë neni 7B që e ndalon detyrimin e bashkësive fetare kundër vullnetit të tyre, mirëpo ajo theksoi se këto çështje do të analizohen pas miratimit në parim të projektligjit.

Etem Arifi theksoi se pas hyrjes së ligjit në fuqi, bashkësitë fetare duhet të aplikojnë për statusin e tyre dhe të japin informacione rreth lokacioneve dhe objekteve të tyre që shtrihen në rajonin e Kosovës.

Agron Gashi theksoi se kjo çështje në praktikë do të sjellë probleme serioze. Ai ju referuar diskutimeve paraprake që i ka bërë me përfaqësuesit e bashkësive fetare të cilët kanë shfaqur shqetësimet e tyre lidhur me këtë nen dhe për këtë arsye është përcaktuar që bashkësitë fetare ekzistuese konsiderohen të regjistruara në momentin e krijimit të Zyrës për Regjistrim. Këtë sqarim ai e bëri me qëllim të lehtësimit të procedurës, sepse sipas deklarimeve të përfaqësuesve të bashkësisë katolike të Kosovës për të pasur të drejtë të aplikojnë për regjistrim ata duhet ta marrin lejen e Vatikanit dhe kjo do të krijonte zvarritje apo probleme të tjera në praktikë dhe për këtë arsye është përcaktuar një nen i tillë.

Lirije Kajtazi lidhur me këtë theksoi se për këto arsye është i nevojshëm ligji sipas të cilit do të rregullohen çështje të shumta të bashkësive fetare dhe në aspektin fetar në përgjithësi. Ai ishte e mendimit që ky projektligj duhet të kalojë në parim nga Kuvendi i Kosovës e më pas Komisioni të merret me shqyrtimin dhe amendamentimin e tij.

Mytaher Haskuka tha se është takuar me disa përfaqësues të Bashkësisë Islame dhe Bashkësisë së besimit katolik në Kosovë dhe të dyja palët kanë konstatuar se nuk janë konsultuar nga institucionet lidhur me këtë projektligj i cili ka dallime esenciale nga projektligji i mëparshëm.

Lirije Kajtazi duke u ndërlidhur me parafolësin theksoi se do t'i ftojë të gjithë përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë dhe ata do të kenë mundësinë t'i paraqesin vërejtjet e tyre lidhur me projektligjin në mënyrë që projektligji të jetë sa më mirë i hartuar dhe të rregulloj të drejtat, por edhe statusin e bashkësive fetare në Kosovë. Ajo, po ashtu, theksoi se ky ligj bën pjesë në ligjet me interes vital për miratimin e të cilit kërkohet edhe shumica e pakicave dhe për këtë çështje Rregullorja e Punës së Kuvendit ka sqaruar që për miratimin e këtij projektligj kërkohet shumica e dyfishtë, gjë që nevojitet edhe pjesëmarrja e komuniteteve pakicë.

Ajo në vazhdim e theksoi se duke marrë parasysh qëndrimin e mëhershëm, pro këtij projektligji, të anëtarit të Komisionit z. Nenad Rashiq, do të marrin parasysh këtë edhe në këtë votim pasi që bëhet fjalë vetëm për miratimin në parim.

Ajo i ftoi për votim anëtarët e Komisionit për miratimin në parim të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte:

Për - 5 deputetë,

Abstenim - 1 deputet,
Kundër - 0.

Më pas, kryetarja, konstatoi se Komisioni FunkSIONAL, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë.

4. Të ndryshme

Lirije Kajtazi i njoftoi anëtarët e Komisionit se lidhur me kërkesën e punëtorëve të “Sharr Salonitit” ajo ka takuar Avokatin e Popullit dhe ka kërkuar që ai të kërkojë sqarime nga Gjykata Supreme, si dhe mundësisht të shpejtohet procedurën për këtë çështje.

Gjithashtu ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit se më 28 tetor 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit organizon tryezë me titull “Të drejtat e njeriut dhe raportimi në media “.

Ajo ftoi anëtarët e Komisionit që mundësisht të marrin pjesë në këtë takim.

Në fund ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit për punëtorin që do të mbahet më 31 tetor dhe 1 e 2 nëntor lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

Teuta Haxhiu kërkoi informacione se a do të jetë ndonjë ekspert prezent në këtë tryezë lidhur me projektligjin në fjalë.

Lirije Kajtazi tha se punësoria do të jetë gjithëpërfshirëse dhe se UNICEF-i ka njoftuar se do ta sjellë një ekspert lidhur me këtë çështje.

Mexhide Mjaku – Topalli duke u ndërlidhur me takimin e fundit që kishte karakter të Dëgjimit Publik që kishte për qëllim monitorimin e zbatimit të rekomandimeve që kanë dalë nga raporti i monitorimit të Ligjit për personat e verbër, kërkoi informacione se a do të ketë takim tjetër apo çdo gjë ka përfunduar me atë takim që është mbajtur.

Po ashtu ajo kërkoi informacione se kur do të mbahet një Dëgjim Publik lidhur me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve që kanë dalë nga Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu e përmendi edhe çështjen e grupit punues për shqyrtimin e Draft-udhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve duke precizuar nevojën e një takimi tjetër lidhur me këtë në mënyrë që kjo të përfundojë me miratimin e tij. Ajo pyeti se kush do të jetë udhëheqës i Grupit Punues dhe kur pritet të fillojnë punën lidhur me këtë çështje.

Lirije Kajtazi, Lidhur me Dëgjimin Publik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve që kanë dalë nga raporti i monitorimit të Ligjit për personat e verbër, tha se shumica e materies është konsumuar në atë takim dhe do të duhet që për ndonjë informacion shtesë, institucionet përgjegjëse të njoftojnë Komisionin me shkrim.

Rreth çështjes së Draft-udhëzuesit për shqyrtimin e peticioneve ajo theksoi se Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit do ta prekë edhe këtë çështje të trajtimit të peticioneve. Sa i përket udhëheqësit të Grupit Punues ajo e ritheksoi se mund të vazhdohet prapë ashtu siç ka qenë më parë dhe stafi i Komisionit që të dërgojë informacione për znj. Mexhide Mjaku-Topalli, që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në takimet e Nënkomisionit kur do të trajtohet kjo çështje.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI